



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 05.09.2016 Ref.: 792/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr. 421/16 e datës 21.07.2016 e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", si e pa bazuar.

II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.636/16, datë 15.07.2016.

A r s y e t i m i

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë (nr. 421/16, dt. 21.07.2016) për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (nr. 636/16, datë 15.07.2016). Përmes kësaj kërkesë, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka kërkuar të rishqyrtohet vendimi i KSHC-së në lidhje me kohëzgjatjen e periudhës së akreditimit të programeve: Termoenergjetikë dhe Termoteknikë, BSc dhe MSc, Konstruksione dhe Mekanizim, BSc dhe MSc, Mekatronikë, BSc dhe MSc, Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti, BSc, nga 3 vite sa është përcaktuar në vendimin e KSHC-së në 5 vite ashtu siç është rekomanduar në raportin final të ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit.

KSHC ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës dhe ka vendosur të refuzojë kërkesën për rishqyrtim të datës 21.07.2016 dhe të lë në fuqi vendimin e KSHC-së të marrë më datë 15.07.2016.

Për sa i përket kohëzgjatjes së akreditimit për programet e cekura më sipër, KSHC ka vlerësuar gjendjen e stafit akademik të dorëzuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike. Sipas shënimeve në bazën e të dhënave të AKA-së, KSHC ka konstatuar se një pjesë e konsiderueshme e stafit akademik e paraqitur si staf i rregullt nga fakulteti do të pensionohet në vitet e ardhshme. Duke

pasur parasysh se AKA nuk merr për bazë stafin e pensionuar, në përputhje me Ligjin e Punës, neni 67, pika 1.4., ka konsideruar se stafi i cili do të pensionohet nuk do të garantojë qëndrueshmërinë në ofrimin e programeve të studimit për 5 vitet e ardhshme. Meqenëse, KSHC nuk ka pranuar asnjë plan zhvillimor të stafit apo plan për rekrutimin e stafit të ri akademik, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.02/2013, datë: 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, KSHC ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket emërtimit të programeve të studimit përfshirë specializimet, të dhënat janë marrë nga faja e parë e aplikacionit të Fakultetit, pasi që në Raportin Final të ekspertëve nuk është cekur taksativisht që këto specializime janë tërhequr. Në Komentet e Fakultetit të bëra ndaj Draft Raportit të ekspertëve është cekur se fakulteti ka plane të bëjë shuarjen e specializimeve mirëpo nuk ka pasur dëshmi konkrete. Për më tepër, institucionet e arsimit të lartë mund të komentojnë në draft raportet e ekspertëve vetëm për gjendjen faktike të raportit, nëse pretendohet se faktet janë paraqitur ndryshe nga ato që institucioni i ka prezantuar. Institucionet e arsimit të lartë nuk mund të komentojnë në rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë. Si rrjedhojë, kërkesa për tërheqjen e specializimeve nga vendimi i KSHC-së të datës 15.07.2016 është i pabazë dhe vendimi nuk mund të ndryshohet.

Për sa i përket përfshirjes së profesorëve Prof. Dr. Shaban Buza dhe Prof. Dr. Januz Bunjaku, si bartës të programeve të studimit, KSHC ka konstatuar që asnjëri nga dy personat e mësipërm nuk është në marrëdhënie të rregullt pune në këtë program të studimit, përkatësisht në këtë fakultet, për këto arsye:

- Prof.Dr. Shaban Buza ka dorëzuar deklaratë më shkrim në AKA me të cilën ka konfirmuar se ka marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" (deklarata me datë 15.10.2015). Gjithashtu ka dorëzuar edhe vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetin të Gjakovës "Fehmi Agani" për zgjedhjen e tij në pozitën e Rektorit të Universitetin të Gjakovës "Fehmi Agani" (vendimi nr.01/2428, datë. 09.10.2015). Andaj duke u bazuar në këto fakte, Prof.Dr. Shaban Buza nuk mund të pranohet si staf i rregullt në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.
- Prof.Dr. Jonuz Bunjaku ka dorëzuar deklaratë më shkrim në AKA me të cilën ka konfirmuar se ka marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" (deklarata e datës 16.11.2015). Gjithashtu ka dorëzuar edhe vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetin të Gjakovës "Fehmi Agani" për zgjedhjen e tij në pozitën e Prorektorit për buxhet dhe financa (vendimi nr.01/2574, datë. 04.11.2015). Andaj duke u bazuar në këto fakte, Prof. Dr. Jonuz Bunjaku nuk mund të trajtohet si staf i rregullt në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.

Në lidhje me kërkesat për sqarime për procedurat administrative të vlerësimit dhe akreditimit, KSHC konsideron se këto janë çështje të brendshme të AKA-së të rregulluara me rregullore të punës dhe Udhëzim Administrativ. Deklarimet për mospërputhjet e gjetura në raportin final të

ekspertëve dhe vendimin e KSHC-së, KSHC konsideron se nuk qëndrojnë dhe nuk shërbejnë si bazë për të ndryshuar vendimin e datës 15.07.2016.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë